

PROJEKTLIGJ PER FONDIN E ZHVILLIMIT TE SHOQERISE CIVILE

TABELA E LËNDËS

| | |
|---|----------|
| KREU I | 4 |
| DISPOZITA TË PËRGJITHSHME..... | 4 |
| Neni 1 | 4 |
| Objekti | 4 |
| Neni 2..... | 4 |
| Personaliteti juridik | 4 |
| Neni 3..... | 4 |
| Perkufizime..... | 4 |
| KREU II | 5 |
| MISIONI DHE OBJEKTIVAT E FZSHC-SE..... | 5 |
| Neni 4..... | 5 |
| Misioni dhe objektivat..... | 5 |
| KREU III | 5 |
| SUBJEKTET PERFITUESE DHE PARIMET E PERZGJEDHJES | 5 |
| Neni 5..... | 5 |
| Subjektet perfituese | 5 |
| Neni 6..... | 5 |
| Parimet e perzgjedhjes | 5 |
| KREU IV | 6 |
| ORGANET E FZSHC-SE..... | 6 |
| Neni 7 | 6 |
| Organet e FZSHC-se..... | 6 |
| Neni 8..... | 6 |
| Perberja e Bordit Mbikeqyres..... | 6 |
| Neni 9..... | 6 |
| Detyrat e kompetencat e Bordit Mbikeqyres | 6 |
| Neni 10..... | 7 |
| Vendimmarrja e Bordit Mbikeqyres | 7 |
| Neni 11 | 7 |
| Kryetari i Bordit Mbikeqyres | 7 |
| Neni 12..... | 7 |
| Drejtori ekzekutiv i FZSHC-se | 7 |
| Neni 13..... | 8 |
| Kohezgjatja e mandatit te organeve drejtuese te FZSHC-se..... | 8 |
| Neni 14 | 9 |
| Parandalimi i konfliktit te interesave..... | 9 |
| Neni 15..... | 9 |
| Administrata e FZSHC-se..... | 9 |
| KREU V | 9 |
| STATUTI DHE AKTET E TJERA TE FZSHC-SE..... | 9 |
| Neni 16..... | 9 |
| Statuti dhe aktet e tjera te FZSHC-se | 9 |
| KREU VI..... | 9 |
| BURIMET E FINANCIMIT TE FZSHC-SE | 9 |
| Neni 17 | 9 |
| Burimet e financimit..... | 9 |
| Neni 18..... | 10 |

| | |
|---|-----------|
| Selia e FZSHC-se..... | 10 |
| Neni 19..... | 10 |
| Llogarite bankare | 10 |
| KREU VII..... | 10 |
| PROCEDURAT E PERZGJEDHJES E TE VENDIMMARRJES | 10 |
| Neni 20..... | 10 |
| Zbatimi i rregullave te prokurimit publik | 10 |
| Neni 21..... | 10 |
| Pergjegjesite e organeve te FZSHC-se per sherndarjen e fondeve | 10 |
| Neni 22..... | 11 |
| Konkurrimi | 11 |
| Neni 23..... | 11 |
| Procedura baze..... | 11 |
| Neni 24..... | 11 |
| Projektet | 11 |
| Neni 25..... | 12 |
| Dokumentet e konkurrimet | 12 |
| Neni 26..... | 12 |
| Hartimi i projektpropozimeve..... | 12 |
| Neni 27..... | 12 |
| Informimi i publikut e format e komunikimit..... | 12 |
| Neni 28..... | 12 |
| Njoftimet | 12 |
| Neni 29..... | 12 |
| Afatet kohore per dorezimin e projektpropozimeve | 12 |
| Neni 30..... | 13 |
| Sqarimet..... | 13 |
| Neni 31..... | 13 |
| Kriteret e perjashtimit, kualifikimit e skualifikimit..... | 13 |
| Neni 32..... | 13 |
| Paraqitja, pranimi, ndryshimi e terheqja e projektpropozimeve | 13 |
| Neni 33..... | 13 |
| Hapja e shqyrtimi i projektpropozimeve | 13 |
| Neni 34..... | 14 |
| Kriteret e percaktimit te projektpropozimit fitues | 14 |
| Neni 35..... | 14 |
| Skema e perlllogaritjes se projektpropozimit fitues..... | 14 |
| Neni 36..... | 14 |
| Njoftimi i fituesit dhe nenshkrimi i kontrates..... | 14 |
| Neni 37..... | 14 |
| Zbatimi i kontrates..... | 14 |
| Neni 38..... | 15 |
| Rishikimi e hetimi administrativ..... | 15 |
| KREU VIII..... | 15 |
| AUDITIMI E RAPORTIMI FINANCIAR I VEPRIMTARISE SE FZSHC-SE..... | 15 |
| Neni 39..... | 15 |
| Auditimi..... | 15 |
| Neni 40..... | 15 |
| Raportimi financiar | 15 |
| KREU IX..... | 15 |
| DISPOZITA KALIMTARE E TE FUNDIT | 15 |
| Neni 41..... | 15 |
| Emerimi i anetareve te Bordit te pare Mbikeqyres | 15 |
| Neni 42..... | 15 |
| Buxheti i FZSHC-se per vitin 2008 | 15 |
| Neni 43..... | 16 |

| | |
|-----------------------------------|----|
| Nxjerrja e akteve nenligjore..... | 16 |
| Neni 44 | 16 |
| Hyrja ne fuqi | 16 |

PROJEKTLIGJ

PER FONDIN E ZHVILLIMIT TE SHOQERISE CIVILE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Objekti

Objekti i këtij ligji është organizimi dhe funksionimi i Fondit të Zhvillimit të Shoqërisë Civile, në vijim FZSHHC, dhe procedurave të zbatueshme për shpërndarjen e fondeve për mbështetje për shoqëri civile.

Neni 2 Personaliteti juridik

FZSHHC-ja është ent publik qendror që ka personalitet juridik dhe vepron për përmbushjen e misionit dhe objektivave të tij në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi.

Neni 3 Perkufizime

Në kuptim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

1. “Fondi për mbështetje të shoqërisë civile” është çdo fond publik i cili destinohet për mbështetje për shoqëri civile sipas ligjit.
2. “Autoriteti financiar” është Fondi i Zhvillimit të Shoqërisë Civile dhe/ose çdo autoritet publik, qendror a vendor, që shpërndan fonde nga buxheti i tij për mbështetjen e shoqërisë civile.
3. “Kandidat” është çdo subjekt përfitues që merr pjesë në një procedurë konkurrimi sipas këtij ligji.
4. “Granti” është shuma e përcaktuar e fondit për mbështetje të shoqërisë civile, e njoftuar në dokumentet e konkurrimit gjatë një procedure konkrete, që i dhurohet pa interes subjektivit përfitues nga autoriteti financiar në përputhje me kriteret e vendosura sipas këtij ligji.
5. “Dokumentet e konkurrimit” janë dokumentet që autoriteti financiar ua ve në dispozicion të gjithë kandidatëve të interesuar për përgatitjen e projektpropozimeve.
6. “Shpenzime të pranueshme” janë shpenzimet që merren parasysh për një fond për mbështetje të shoqërisë civile.

KREU II MISIONI DHE OBJEKTIVAT E FZSHC-se

Neni 4 Misioni dhe objektivat

1. FZSHC-ja ka si mision themelor nxitjen e zhvillimit te qendrueshem te shoqerise civile dhe krijimin e kushteve te favorshme per iniciativat civile ne te mire dhe interes te publikut.
2. Per realizimin e misionit te tij, FZSHC-ja ofron mbeshtetje e asistence profesionale e financiare per programet qe nxisin e forcojne qendrueshmerine e organizatave jofitimpruese, bashkepunimin ndersektorial e nderkombetar, iniciativat civile, filantropine, vullnetarizmin e institucionet demokratike te shoqerise si dhe programe te tjera qe lehtesojne permbushjen e misionit te tij.
3. Ne ushtrimin e veprimtarise se tij, FZSHC-ja udhehiqet nga prioritetet strategjike te institucioneve publike per zhvillimin e shoqerise civile.
4. Dispozitat e mesiperme te ketij neni jane te zbatueshme per cdo autoritet tjeter financues sipas ketij ligji.

KREU III SUBJEKTET PERFITUESE DHE PARIMET E PERZGJEDHJES

Neni 5 Subjektet perfituese

FZSHC-ja dhe cdo autoritet tjeter financues mbeshtetin e asistojne, sipas percaktimeve te ketij ligji dhe ne perputhje me prioritetet strategjike, nisma, programe e veprimtari me karakter jofitimprues:

- a) te organizatave te shoqerise civile te cilat jane te regjistruara sipas ligjit dhe ushtrojne veprimtari sipas objektit te percaktuar ne statutin e tyre, me perjashtim te partive politike, sindikatave, institucioneve te sigurimeve e fetare dhe organizatave qe ushtrojne veprimtari kryesore te drejtperdrejte politike;
- b) te personave fizike dhe iniciativave civile ne interes e dobi te publikut.

Neni 6 Parimet e perzgjedhjes

Ne procesin e shqyrtimit e te perzgjedhjes se kandidatave perfitues dhe te shperndarjes se fondeve per mbeshtetje te shoqerise civile sipas ketij ligji, cdo autoritet financues mbeshtetet ne parimet e meposhtme:

- a) lirine e pjesemarrjes dhe konkurrimit;
- b) mosdiskriminimin e trajtimin e barabarte;
- c) transparencen e procedurave e te vendimmarrjes, duke iu ofruar te gjithe kandidatave informacionin dhe proceduren perkatese;
- ç) perputhshmerine me objektivat e grantit dhe efektivitetin e perdorimit te burimeve, duke perdorur sistemin e konkurrimit dhe kriteret qe mundesojne vleresimin e projektpropozimit dhe specifikimet teknike e financiare per perzgjedhjen e shperndarjen e grantit;
- d) bashkefinansimin, duke mundesuar financimin e veprimtarise me kontribute te tjera;
- dh) mungesen e prapaveprimit, duke perjashtuar mundesine e shperndarjes se fondeve per veprimtari tashme te realizuara ne daten e vendimmarrjes;
- e) paanshmerine e shqyrtimit e te vendimmarrjes dhe parandalimin e konfliktit te

- interesave;
- ë) perjashtimin e mbivendosjes, qe nenkupton shmangien e financimit te te njejtës veprimtari per te njejtin interes konkret me shume se nje here gjate nje viti fiskal.

KREU IV ORGANET E FZSHHC-SE

Neni 7 Organet e FZSHHC-se

1. Organet e FZSHHC-se jane Bordi Mbikeqyres dhe Drejtori ekzekutiv.
2. Statuti i FZSHHC-se mund te percaktoje organe te tjera ekzekutive, keshillimore ose ndihmese te tij.
3. Procedurat e organizimit dhe funksionimit te organeve te FZSHHC-se percaktohen ne statutin e tij dhe vendimet e Bordit Mbikeqyres.
4. Anetaret e organeve te FZSHHC-se i kryejne funksionet e tyre ne perputhje me dispozitat e ketij ligji, legjislacionit ne fuqi, statutit dhe akteve te tjera te pergjithshme te FZSHHC-se.

Neni 8 Perberja e Bordit Mbikeqyres

1. FZSHHC-ja drejtohet nga Bordi Mbikeqyres i cili perbehet nga 9 (nente) anetare.
2. Bordi Mbikeqyres i FZSHHC-se perbehet nga 5 anetare qe perfaqesojne organizatat e shoqerise civile dhe 4 anetare qe perfaqesojne institucione te administrates publike qendrore.
3. Keshilli i Ministrave emerohet, sipas pikes 2 te ketij neni, 4 anetare te Bordit Mbikeqyres nga perfaqesues te institucioneve te administrates publike qendrore dhe 5 anetare nga perfaqesues te organizatave te shoqerise civile.
4. Perfaqesuesit e organizatave te shoqerise civile emerohen ne Bordin Mbikeqyres sipas pikes 3 te ketij neni ne baze te pervojes e kontributit te tyre sipas perfaqesimit proporcional te fushave kryesore e prioritare te zhvillimit dhe prioriteteve strategjike per zhvillimin e shoqerise civile. Organizatat e shoqerise civile te regjistruara sipas ligjit kane te drejte te dergojne propozimet e tyre per perfaqesimin ne Bordin Mbikeqyres prane Sekretarit te Pergjithshem te Keshillit te Ministrave.
5. Procedura dhe rregullat per per zbatimin e ketij neni percaktohen me vendim te Keshillit te Ministrave.

Neni 9 Detyrat e kompetencat e Bordit Mbikeqyres

1. Bordi Mbikeqyres kryen keto detyra e kompetenca:
 - a) miraton statutin e FZSHHC-se;
 - b) miraton, ne baze te ketij ligji, rregulla te detajuara mbi kushtet e procedurat per shperndarjen e fondeve per permbushjen e misionit te FZSHHC-se;
 - c) shqyrton raportet e veprimtarise se FZSHHC-se dhe miraton planin e veprimeve sipas fushave qe percakton;
 - ç) miraton buxhetin vjetor te funksionimit te FZSHHC-se;
 - d) miraton raportet financiare;

- dh) miraton rregullat e funksionimit te personelit;
 - e) vendos per perdorimin e pasurise se FZSHHC-se;
 - ë) zgjedh, liron e shkarkon kryetarin e nenkryetarin e tij;
 - f) emeron, liron e shkarkon nga detyra drejtorin ekzekutiv;
 - g) raporton ne Keshillin e Ministrave per veprimtarine e FZSHHC-se dhe
 - gj) kryen detyra te tjera ne perputhje me dispozitat e ketij ligji dhe statutin e FZSHHC-se.
2. Kryetari e anetaret e Bordit Mbikeqyres marrin nje shperblim vjetor te percaktuar nga Keshilli i Ministrave.

Neni 10

Vendimmarrja e Bordit Mbikeqyres

1. Mbledhja mund te mbahet nese shumica e anetareve te Bordit Mbikeqyres jane te pranishem. Vendimet e Bordit Mbikeqyres merren me shumice te thjeshte te anetareve te pranishem ne mbledhje, me perjashtim te rasteve te percaktura ne piken 1 te nenit 11 dhe pikes 4 te nenit 12 te ketij ligji si dhe te vendimeve per miratimin ose ndryshimin e statutit te FZSHHC-se dhe per menyren e perdorimit te pasurise se paluajtshme te tij.
2. Mbledhjet e Bordit Mbikeqyres jane te hapura per publikun, pervec rasteve kur ligji parashikon ndryshe. Vendi, data, ora dhe rendi i dites i mbledhjeve njoftohen paraprakisht sipas pikes 3 te ketij neni.
3. Vendimet e Bordit Mbikeqyres botohen ne kendin e botimeve ne seline e FZSHHC-se ose me çdo mjet tjeter te pershtatshem ne perputhje me percaktimet e statutit ose te akteve te FZSHHC-se.
4. Per aq sa nuk percaktohet ndryshe ne kete ligj, funksionimi e vendimmarrja e Bordit Mbikeqyres kryhet sipas ligjit nr.8480, date 27.05.1999 "Per funksionimin e organeve kolegjiale te administrates shteterore dhe enteve publike".

Neni 11

Kryetari i Bordit Mbikeqyres

1. Kryetari e nenkryetari i Bordit Mbikeqyres zgjidhen, lirohen e shkarkohen nga detyra me shumicen e thjeshte te numrit te pergjithshem te anetareve te Bordit Mbikeqyres. Propozimi për shkarkimin e tyre bëhet nga të paktën një e treta e anëtarëve te Bordit.
2. Kryetari i Bordit Mbikeqyres kryen keto detyra:
 - a) therret mbledhjet e tij, percakton rendin e dites dhe drejton mbledhjet e Bordit Mbikeqyres sipas rregullave e procedurave te percaktuara ne statutin e FZSHHC-se;
 - b) perfaqeson Bordin Mbikeqyres ne marredheniet me pale te treta;
 - c) mbikeqyr zbatimin e vendimeve te Bordit Mbikeqyres;
 - ç) bashkerendon veprimtarine e funksionimin e organeve te FZSHHC-se sipas pikes 2 te nenit 7 te ketij ligji;
 - d) propozon zgjedhjen a emerimin, lirimin e shkarkimin e anetareve te Bordit Mbikeqyres dhe te Drejtorit ekzekutiv; si dhe
 - dh) kryen çdo detyre tjeter te percaktuar ne statutin e FZSHHC-se ose te ngarkuar nga Bordi Mbikeqyres.
3. Ne mungese e pamundesi te Kryetarit, detyrat e tij i kryen Nenkryetari i Bordit Mbikeqyres.

Neni 12

Drejtori ekzekutiv i FZSHHC-se

1. Drejtori ekzekutiv kryen keto detyra:
 - a) perfaqeson FZSHHC-ne ne marredheniet me pale te treta;
 - b) administron, mbikeqyr e drejton veprimtarine e FZSHHC-se dhe te administrates se tij, perfshire punesimin e administrimin e personelit, ne perputhje me ligjin, statutin e FZSHHC-se dhe vendimet e Bordit Mbikeqyres;
 - ç) i paraqet per shqyrtim e miratim Bordit Mbikeqyres projektplanin e veprimeve, projektbuxhetin, rregulloren e brendshme, raportin vjetor financiar, raporte per gjendjen financiare te FZSHHC-se si dhe çdo raportim tjetër me interes;
 - d) i ben propozime e sugjerime Bordit Mbikeqyres sa here qe i kerkohet ose kryesisht per mbarevajtjen e veprimtarise se FZSHHC-se;
 - dh) siguron bashkepunimin me institucionet publike dhe personat juridike, vendas a te huaj, per mbarevajtjen e veprimtarise se FZSHHC-se; si dhe
 - e) ushtron çdo detyre tjetër qe nuk i eshte dhene organeve te tjera te FZSHHC-se, ne perputhje me dispozitat e ketij ligji, legjislacionit ne fuqi dhe statutit te FZSHHC-se.
2. Anetaret e Bordit Mbikeqyres ose debitore te FZSHHC-se nuk mund te emerohen ne detyren e Drejtorit ekzekutiv te FZSHHC-se.
3. Drejtori ekzekutiv merr pjese ne mbledhjet e Bordit Mbikeqyres pa te drejte vote dhe ka te drejten te propozoje çeshtje per t'u perfshire ne rendin e dites se mbledhjeve te Bordit Mbikeqyres.
4. Drejtori ekzekutiv emerohet dhe shkarkohet me shumicen e thjeshte te numrit te pergjithshem te anetareve te Bordit Mbikeqyres.

Neni 13

Kohezgjatja e mandatit te organeve drejtuese te FZSHHC-se

1. Kohezgjatja e mandatit te anetarit te Bordit Mbikeqyres eshte 4 vjet, me te drejte rizgjedhjeje vetem nje here. Mandati i anetarit te Bordit Mbikeqyres mbaron perpara afatit ne rastet kur:
 - a) jep doreheqjen;
 - b) krijohen kushte te papajtueshmerise a konfliktit te interesit sipas nenit 14 te ketij ligji;
 - c) humbet zotesine juridike per te vepruar me vendim gjykate;
 - ç) nuk merr pjese ne te pakten gjysmen e mbledhjeve te Bordit Mbikeqyres te organizuara gjate nje viti;
 - d) vdes;
 - dh) denohet per kryerjen e nje vepre penale me vendim gjykate te formes se prere.
2. Kohezgjatja e mandatit te Drejtorit ekzekutiv eshte 5 vjet, me te drejte riemerimi. Mandati i Drejtorit ekzekutiv mbaron para afatit sipas percaktimeve te shkronjave "a" deri ne "dh" te pikes 1 te ketij neni.
3. Keshilli i Ministrave shkarkon anetarin e Bordit Mbikeqyres nga detyra kur konstaton shkelje te ligjit dhe akteve te pergjithshme te FZSHHC-se, kur ai ka interesa profesionale e financiare qe jane ne konflikt me interesat e FZSHHC-se, ose kur sjellja e qendrimi i tij cenon reputacionin e FZSHHC-se.
4. Bordi Mbikeqyres shkarkon nga detyra Drejtorin ekzekutiv kur konstaton nje nga shkeljet e permendura ne piken 3 te ketij neni.
5. Emerimi i anetarit te ri te Bordit Mbikeqyres ose i Drejtorit ekzekutiv behet jo me vone se 30 dite nga mbarimi i mandatit.

Neni 14

Parandalimi i konfliktit te interesave

Anetari i Bordit Mbikeqyres ose i çdo organi tjetër te FZSHC-se nuk mund te votoje ose te marre pjese ne vendimmarrje ne te cilen ai, bashkeshorti ose bashkeshortja, biresuesi ose i biresuari, i afermi, ne vije te drejtperdrejte ose te terthorte, me lidhje gjaku ose krushqie deri ne shkalle te dyte ka interes financiar, ose ne ceshtjet qe lidhen me nje person juridik kur ai eshte anetar, merr pjese ne administrimin e tij ose ka interes financiar ne te sipas ligjit.

Neni 15

Administrata e FZSHC-se

1. Struktura e administrates se FZSHC-se percaktohet ne statutin e tij.
2. Numri i punonjesve te FZSHC-se miratohet nga Keshilli i Ministrave si ze me vete, ne perputhje me ligjin per Buxhetin vjetor te Shtetit.
3. Nivelet e pagave dhe te shperblimit te punonjesve te FZSHC-se miratohen nga Keshilli i Ministrave, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi. Marredheniet e punes se punonjesve te FZSHC-se rregullohen sipas Kodit te Punes.
4. FZSHC-ja bashkepunon me institucionet shteterore dhe personat juridike, vendas e te huaj, ne perputhje me percaktimet e statutit te tij.

KREU V

STATUTI DHE AKTET E TJERA TE FZSHC-se

Neni 16

Statuti dhe aktet e tjera te FZSHC-se

1. Organet e FZSHC-se e ushtrojne veprimtarine e tyre ne baze te ligjit dhe statutit te tij.
2. Aktet e tjera te FZSHC-se duhet te jene ne perputhje me dispozitat e ketij ligji, legjislacionin ne fuqi dhe statutin e FZSHC-se.
3. Statuti i FZSHC-se miratohet nga Keshilli i Ministrave.

KREU VI

BURIMET E FINANCIMIT TE FZSHC-se

Neni 17

Burimet e financimit

1. Burimet e financimit te FZSHC-se jane:
 - a) financimi nga Buxheti i Shtetit dhe kontributet ne natyre te miratuara me vendim te Keshillit te Ministrave;
 - b) te ardhurat e veta;
 - c) dhurime te tjera te ligjshme;
 - ç) te ardhura te tjera te percaktuara me ligj.
2. Financimi i FZSHC-se parashikohet si ze me vete ne ligjin per Buxhetin vjetor te Shtetit. Si rregull, financimi vjetor i siguruar nga Buxheti i Shtetit nuk mund te jete me i vogel per vitin

pasardhes.

3. FZSHHC-ja siguron e pranon te ardhura e dhurime, ne vlere, mallra ose sherbime dhe zbaton rregullat e marreveshjes se nenshkruar me dhuruesin ne perputhje me misionin e tij dhe ligjet ne fuqi.
4. FZSHHC-ja realizon te ardhura sipas ligjit nepermjet administrimit te pasurive te tij dhe ushtrimit te veprimtarive te tjera te ligjshme.

Neni 18
Selia e FZSHHC-se

Selia e FZSHHC-se ndodhet ne Tirane. Keshilli i Ministrave i ve ne dispozicion FZSHHC-se mjedise te pershtatshme per seline e tij.

Neni 19
Llogarite bankare

1. FZSHHC-ja mban llogari ne thesar, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.
2. Fondet e perfituara ne monedhe te huaj depozitohen ne llogari te veçanta bankare.

KREU VII
PROCEDURAT E PERZGJEDHJES E TE VENDIMMARRJES

Neni 20
Zbatimi i rregullave te prokurimit publik

Dispozitat e ligjit nr.9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik" te ndryshuar dhe te akteve nenligjore ne zbatim te tij, te permendura ne nenet e ketij kreu, zbatohen, sipas rastit ne kuptim te ketij ligji, per aq sa nuk bien ne kundershtrim me kete ligj dhe me ligje te tjera.

Neni 21
Pergjegjesite e organeve te FZSHHC-se per sherndarjen e fondeve

1. Fondi ndahet e alokohet sipas fushave qe percakton Bordi Mbikeqyres.
2. Drejtori ekzekutiv i FZSHHC-se:
 - a) siguron hartimin e zhvillimin e kushteve te granteve ne pershtatje me specifikat e fushave;
 - b) shpall publikisht grantin dhe kriteret e konkurrimit e te perzgjedhjes se subjekteve perfituese;
 - c) krijon komisionin e vleresimit te projektpropozimeve, prej jo me pak se 3 vetash per çdo procedure konkurrimi, ne perberjen e te cilit marrin pjese me cilesine e te ftuarit perfaqesues te organizatave te shoqerise civile;
 - ç) percakton afatet dhe personat pergjegjes per negociimin e kushteve ose ndryshimeve te nevojshme ne projektpropozim, sipas kushteve te percaktuara nga komisioni i vleresimit;
 - d) njofton kandidatet pjesemarres ne nje procedure te caktuar;
 - dh) lidh kontraten me fituesin.
3. Komisioni i vleresimit:
 - a) hap, shqyrton dhe vlereson kriteret e kualifikimit te projektpropozimeve te marra, ne daten, vendin dhe kohen e njoftuar ne dokumentet e konkurrimit, ne prani te

- kandidateve pjesemarres e te perfaqesuesve te ftuar te shoqerise civile;
- b) shpall fituesit, duke bere te njohur, sipas rastit, kushtet individuale qe e bejne projektpropozimin fitues.
4. Ne kontrate percaktohen te pakten menyra e transferimit te fondit, dokumentacioni dhe menyra e raportimit financiar dhe atij te performances, llojet e shpenzimeve te njohura e te pranueshme, format e kontrollit, menyra e dokumentimit te shpenzimeve dhe produktit/rezultateve te projektpropozimit te financuar dhe kushte apo pergjegjesi te tjera te ndersjellta.
5. Organi pergjegjes ne autoritetet e tjera financuese ne zbatim te pikave 1 e 2 te ketij neni eshte i njejte me ate te percaktuar sipas rregullave te prokurimit publik.

Neni 22
Konkurrimi

1. Autoritetet financuese ne kuptim te ketij ligji shperndajne dhe alokojne fonde per mbështetje te shoqerise civile mbi bazen e konkurrimit te hapur e perzgjedhjes publike te projektpropozimeve ne perputhje me parimet e proceduren e percaktuar ne kete ligj.
2. Numri i kandidateve pjesemarres ne nje procedure konkurrimi nuk mund te kufizohet. Pjesemarrja e kandidateve ne nje procedure konkurrimi nuk mund te refuzohet vetem per shkak se u kërkohej te jene persona fizike ose juridike.
3. Autoriteti financues perserit proceduren ne rast se eshte paraqitur vetem nje kandidat i interesuar. Ne rastet kur edhe pas perseritjes se procedures se konkurrimit, eshte paraqitur vetem nje kandidat qe ka paraqitur projektpropozim, autoriteti financues mund te vazhdoje proceduren me kushtin qe projektpropozimi te plotesoje kushtet e kualifikimit e te grantit sipas ketij ligji.

Neni 23
Procedura baze

1. Procedura e perzgjedhjes se projektpropozimit perfshin fazat e meposhtme:
- a) botimin e planit vjetor te veprimit;
 - b) njoftimin paraprak e botimin e çdo procedure konkurrimi per nje grant te caktuar dhe venien ne dispozicion te dokumenteve perkatese te konkurrimit;
 - c) ndryshimet e sqarimet e bera gjate procedures;
 - ç) dorezimin e projektpropozimit dhe regjistrimin e kandidateve pjesemarres nga autoriteti financues;
 - d) shqyrtimin e pranueshmerise, plotesimit te aftesive teknike e financiare, regjistrimit dhe vleresimin e projektpropozimit;
 - dh) njoftimin e rezultateve te konkurrimit, perfshire kushtet per pershtatje a ndryshime;
 - e) ne rast refuzimi te te gjithe kandidateve, deklaraten dhe arsyet e ketij refuzimi;
 - ë) negociimin e mundshem per ndryshimet e percaktuara si kusht per miratimin e projektpropozimit fitues;
 - f) negociimin e nenshkrimit e kontrates;
 - g) botimin e informacionit sipas percaktimeve te ketij ligji.
2. Keshilli i Ministrave miraton kontrata tip dhe rregulla procedurale, te zbatueshme per fondet per mbeshtetje te shoqerise civile te cilat shperndahen sipas ketij ligji.

Neni 24
Projektet

1. Projektet permbajne informacion per qellimin, objektivat specifike, veprimtarite, kostot shtese, rezultatet e synuara. Vleresimi i tyre parashtrohet sipas treguesve te qarte e percaktimeve te

justifikuara.

2. Projektet, sipas natyres se tyre, pergatiten per kohezgjatjen e duhur qe nevojitet per realizimin e tyre sipas percaktimeve te ketij ligji, e cila mund te kaloje kufirin e nje viti financiar.

Neni 25

Dokumentet e konkurrimit

1. Autoriteti financues pergatit dokumentet e konkurrimit, te cilat perfshijne te pakten:
 - a) informacione te pergjithshme te autoritetit financues;
 - b) kriteret minimale te kualifikimit dhe dokumentacionin e nevojshem per te provuar keto kriteret;
 - c) kushtet e grantit;
 - ç) udhezime per afatet dhe formalitetet qe duhet te respektohen;
 - d) informacion per kriteret e perdorura per perzgjedhjen e kandidateve.
2. Kushtet e grantit permbajne karakteristikat e projektit, fushen e veprimit, objektivat specifike, veprimtarite e nevojshme per t'u kryer dhe kriteret e vleresimit te rezultateve.

Neni 26

Hartimi i projektpropozimeve

1. Kandidati duhet te hartoje projektpropozimin ne perputhje me kriteret e dokumenteve te konkurrimit.
2. Projektpropozimi teknik hartohet ne perputhje me kushtet e grantit ne menyre qe te jape informacionin e nevojshem per vleresimin teknik.
3. Projektpropozimi financiar hartohet ne menyre te tille qe te jape informacionin e nevojshem per vleresimin financiar.

Neni 27

Informimi i publikut e format e komunikimit

1. Planifikimi dhe zbatimi i procedurave te shperndarjes se fondeve sipas ketij ligji, procedurat e perzgjedhjes, kontratat e nenshkruara ndermjet autoritetit financues e subjektit perfitues si dhe raportimet per shpenzimin e fondeve te dhena sipas ketij ligji jane informacion me interes publik, ne perputhje me kuadrin ligjor per te drejten e informimit per dokumentet zyrtare.
2. Autoriteti financues zbaton dispozitat e neneve 12, pikat 2 e 3, 21, 22, 24, 25 e 36 te ligjit nr.9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik" te ndryshuar.

Neni 28

Njoftimet

Te gjitha njoftimet publike per procedurat e konkurrimit sipas percaktimeve te ketij ligji botohen ne Buletinin e Njoftimeve Publike dhe ne faqen e internetit te autoritetit financues.

Neni 29

Afatet kohore per dorezimin e projektpropozimeve

1. Autoriteti financues duhet te percaktoje dhe perfshije ne lajmerimin per pjesemarrje ne nje procedure konkurrimi afatin e dorezimit te projektpropozimeve. Ky afat nuk mund te jete me i vogel se 30 dite kalendarike nga botimi i lajmerimit.

2. Ne raste emergjente kur programi qe do te realizohet perben nje interes imediat per publikun dhe/ose kur respektimi i afatit te mesiperm mund te shkaktoje dem per autoritetin financues, ai ka te drejte te zbatoje nje afat te shkurtuar qe nuk mund te jete me pak se 15 dite.
3. Ne rastet e permendura ne piken 2 te ketij neni, autoriteti financues duhet te perfshije ne lajmerimin per pjesemarrje ne konkurrim arsyet e shkurtimeve te afatit te permendur ne piken 1 te ketij neni.
4. Autoriteti financues ka te drejte te zgjase afatin e paraqitjes se projektpropozimit, me kusht qe afati i ri te jete botuar publikisht, te pakten 6 dite para skadimit te afatit te meparshem.

Neni 30

Sqarimet

1. Çdo person juridik ose fizik qe ka marre, ne perputhje me dispozitat e ketij ligji, nje kopje te dokumenteve te konkurrimin ka te drejte te kerkoje e te marre sqarime te metejshme nga autoriteti financues.
2. Autoriteti financues ka detyrimin te jape pergjigje per çdo kerkese sqarimi, me kusht qe kerkesa te jete marre jo me vone se 5 dite para afatit te paraqitjes se projektpropozimeve.
3. Autoriteti financues duhet te ktheje pergjigje per çdo kerkese sqarimi te pakten 3 dite para afatit te paraqitjes se projektpropozimeve.
4. Autoriteti financues ka te drejte, me nismen e tij, te jape informacion sqarues shtese per dokumentet e konkurrimin dhe duhet t'ia komunikojte ate te gjithe kandidatave sipas afateve te pikave te mesiperme te ketij neni.

Neni 31

Kriteret e perjashtimit, kualifikimit e skualifikimit

1. Ne zbatim te ketij ligji, autoriteti financues zbaton dispozitat e meposhtme te ligjit nr.9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik" te ndryshuar:
 - a) nenin 26 per veprimet korruptive dhe konfliktin e interesave;
 - b) nenin 45 per kriteret e perjashtimit te kandidatave;
 - c) kriteret per kualifikimin e kandidatave sipas nenit 46 per aq sa ato jane te zbatueshme ne kuptim te percaktimeve te ketij ligji.
 - ç) kriteret per skualifikimin sipas nenit 47.
2. Përjashtimi i kandidatave kryhet sipas nenit 13, pika 3 te ligjit nr.9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik" te ndryshuar.

Neni 32

Paraqitja, pranimi, ndryshimi e terheqja e projektpropozimeve

Percaktimet e neneve 48, 50 e 51, pikat 1 e 2 te ligjit nr.9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik" te ndryshuar zbatohen per paraqitjen e pranimin, vlefshmerine, ndryshimin e terheqjen e projektpropozimeve.

Neni 33

Hapja e shqyrtimi i projektpropozimeve

Dispozitat e neneve 52, 53, 56, 57 te ligjit nr.9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik" te ndryshuar jane te zbatueshme per hapjen e shqyrtimin e projektpropozimeve dhe administrimin e informacionit.

Neni 34

Kriteret e percaktimit te projektpropozimit fitues

1. Autoriteti financues duhet te permende ne njoftimin per pjesemarrje ne konkurrim dhe ne dokumentet konkurrimit kriteret mbi bazen e te cilave behet percaktimi i projektpropozimit fitues. Keto kriteret mbeten te pandryshueshme gjate te gjithe procedures perkatese.
2. Kriteret e percaktimit te projektpropozimit fitues duhet te mundesojne vleresimin, sipas parimeve te konkurrences, e aftesise se kandidatit per te kryer veprimtarine e propozuar per financim.
3. Kriteret e percaktimit te projektpropozimit fitues duhet te mundesojne vleresimin e cilesive te projektpropozimeve dhe specifikimet teknike e financiare te botuara ne njoftimin per pjesemarrje ne konkurrim.

Neni 35

Skema e perlllogaritjes se projektpropozimit fitues

1. Autoriteti financues shpall fitues projektpropozimin qe arrin rezultatin me te larte dhe qe, sipas skemes se perlllogaritjes, rezulton si projektpropozimi me perparesi me te medha nga pikepamja teknike dhe financiare.
2. Skema e perlllogaritjes e permendur ne piken 1 te ketij neni vendoset duke marre ne konsiderate, se bashku me buxhetin, kriteret te ndryshme per vleresimin e projektpropozimit qe varen nga natyra e grantit. Keto kriteret percaktohen qarte, nepermjet hartimit te normave specifike qe duhet te kene lidhje te ngushte me natyren e kontrates dhe nuk mund te ndryshohen gjate zbatimit te procedures per shperndarjen e grantit.
3. Autoriteti financues duhet te permende ne njoftimin publik dhe ne dokumentet e konkurrimit kriteret per vleresimin e projektpropozimit si dhe skemen e detajuar te perlllogaritjes qe do te zbatohet.

Neni 36

Njoftimi i fituesit dhe nenshkrimi i kontrates

1. Njoftimi i fituesit dhe nenshkrimi i kontrates kryhet sipas nenit 58 te ligjit nr.9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", te ndryshuar.
2. Kontrata e financimit ndermjet autoritetit financues e subjektit perfitues percakton, me pasoje pavlefshmerine e saj, detyrimin e subjektit perfitues per te vene ne dispozicion te Kontrollit te Larte te Shtetit veprimtarine financiare te kryer ne zbatim te saj.

Neni 37

Zbatimi i kontrates

1. Autoriteti financues dhe subjekti perfitues mund te percaktojne ne kontrate se pagesat do t'i behen subjektit perfitues me keste, ne varesi te zbatimit te kontrates dhe shpenzimeve perkatese, ne perputhje me risqet e mundshme financiare, kohezgjatjen e ecurine e veprimtarise se financiar ose ne varesi te organizimit te brendshem ose te kostove te funksionimit te subjektit perfitues.
2. Autoriteti financues nuk i paguan kestin e fundit subjektit perfitues, perpara vleresimit te raportit perfundimtar te veprimtarise dhe bilancit financiar, te cilat subjekti perfitues eshte i detyruar t'ia dorezoje autoritetit financues jo me vone se 30 dite nga perfundimi i veprimtarise.

3. Vleresimi kryhet jo me vone se 30 dite nga marrja e raporteve te permendura ne piken 2 te ketij neni.
4. Autoriteti financues mund te rezervoje te drejten te kerkoje informacion shtese nga subjekti perfitues qofte gjate zbatimit te kontrates ashtu edhe pas vleresimit te raporteve te veprimtarise, me qellim qe te plotesoje dokumentacionin, por jo me vone se 3 muaj nga skadimi i afatit te percaktuar ne piken 3 te ketij neni.
5. Autoriteti financues zbaton dispozitat e kreut VI te ligjit nr.9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", te ndryshuar per zbatimin e kontrates.

Neni 38

Rishikimi e hetimi administrativ

Dispozitat e kreve VII e VIII dhe te neneve 69 deri ne 71 te kreut IX te ligjit nr.9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik" te ndryshuar jane te zbatueshme.

KREU VIII

AUDITIMI E RAPORTIMI FINANCIAR I VEPRIMTARISE SE FZSHHC-se

Neni 39

Auditimi

Veprimtaria financiare e FZSHHC-se auditohet nga njesia e auditimit te brendshem e Ministrise se Financave, sipas legjislacionit ne fuqi.

Neni 40

Raportimi financiar

1. Viti financiar i FZSHHC-se eshte i njejte me vitin kalendarik.
2. Me mbylljen e vitit financiar, Drejtori ekzekutiv, i paraqet auditit te FZSHHC-se bilancin vjetor te te ardhurave e shpenzimeve dhe gjendjen e pasurive te FZSHHC-se per vitin e fundit financiar. Brenda 3 muajve nga mbyllja e vitit financiar, Drejtori ekzekutiv i paraqet Bordit Mbikeqyres raportimin e mesiperm dhe raportin e auditit. Te gjitha anetaret e Bordit Mbikeqyres nenshkruajne raportin financiar te miratuar.

KREU IX

DISPOZITA KALIMTARE E TE FUNDIT

Neni 41

Emerimi i anetareve te Bordit te pare Mbikeqyres

Ngarkohet Keshilli i Ministrave qe, ne baze te pikave 2, 3 e 4 te nenit 8 te ketij ligji, te emeroje anetaret e Bordit te pare Mbikeqyres te FZSHHC-se.

Neni 42

Buxheti i FZSHHC-se per vitin 2008

Buxheti i FZSHHC-se per vitin 2008 perbehet nga fondi i percaktuar ne ligjin nr.9836, date 26.11.2007 "Per buxhetin e shtetit te vitit 2008" i destinuar per mbeshtetje per shoqerine civile sipas fjalise se fundit te nenit 8 dhe tabelës 1 bashkelidhur ligjit te lartpermendur.

Neni 43

Nxjerrja e akteve nenligjore

Ngarkohet Keshilli i Ministrave te nxjerre aktet e nevojshme nenligjore ne zbatim te neneve 8, 9, pika 2, 15, pikat 2 e 3, 16, pika 3, 18 dhe kreut VII te ketij ligji.

Neni 44

Hyrja ne fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.